Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/498
Datë: 27.11.2020

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2020 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. **Riakreditohet** "American Beauty School", me adresë Rr."12 Qershori" në Ferizaj dhe Rr. "Gjon Sereqi" në Gjilan, për periudhën pesë (5) vjeçare,me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Parukeri,** Niveli IV sipas KKK me 32 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 21.03.2020 deri 21.03.2025. "American Beauty School" në Ferizaj dhe në Gjilan për këtë profil, mund të realizojë procesin mësimor me 4 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë maksimumi 25.

2. **Grim,** Niveli III sipas KKK me 9 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 08.05.2020 deri 08.05.2025. "American Beauty School" në Ferizaj dhe në Gjilan për këtë profil, mund të realizojë procesin mësimor me 16 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup të jetë maksimumi 15.

3. **Manikyr,** Niveli III sipas KKK me 5 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 27.12.2020 deri 27.12.2025. "American Beauty School" në Ferizaj dhe në Gjilan për këtë profil, mund të realizojë procesin mësimor me 28 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup të jetë maksimumi 12.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së "American Beauty School" për riakreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi rivalidimin e kualifikimit, si dhe Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi Riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Rivalidim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për Riakreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "American Beauty School";
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK